



P Z A P
I P Ž P

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNİ PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.566/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova kryesuese, Bujar Muzaqi dhe Hajriz Hoti - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Komuna Prishtinë, parashtruar kundër subjektit politik, Koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, Intelektualët me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më datë 13.02.2025, merr këtë :

V E N D I M

I. PRANOHET E BAZUAR ankesa e subjektit politik Lëvizja VETËVENDOSJE! me seli në Komuna Prishtinë, Anr.566/2025 datë 10.02.2025.

II. Subjektit politik AAK-ALEANCA PËR ARDHËRINË E KOSOVËS, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, Intelektualët, me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënim i më gjybë në lartësi prej 1,000.00 Euro (Njëmijë euro) Euro.

III. Detyrohet Subjekti politik AAK-ALEANCA PËR ARDHËRINË E KOSOVËS, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, Intelektualët, me seli në Komuna Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 10.02.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën Anr.566/2025, nga subjekti politik Lëvizja VETËVENDOSJE! në të cilën thekson se ditën e zgjedhjeve dhe gjatë kohës sa qendrat e votimit kanë qenë të hapura, më 9 shkurt 2025, rrëth orës 12, kandidati për deputet i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, z. Agron Kuqi, ka postuar në Facebook një fotografi ku shfaqet duke votuar dhe e ka shoqëruar me përshkrim që përmban sloganin e fushatës së subjektit: "Kosovë fituese". Kështu z. Kuqi ka bërë fushatë gjatë kohës sa qendrat e votimit kanë qenë të hapura, çka ndalohet me nenin 37.1.2 të LZP-së. Z. Kuqi gjithashtu ka shfrytëzuar rrjetet sociale me qëllim të ndikimin tek votuesi, në kundërshtim me nenin 8.1.5 të Rregullores (KQZ) nr. 07/2024 për fushatën e zgjedhjeve, monitorimin e fushatës së

zgjedhjeve dhe deklarimin financier. Parashtruesi i ankesës ka kërkuar nga PZAP të shqiptojë sanksionet e parapara me legjislacionin në fuqi.

Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një CD.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik AAK-ALEANCA PËR ARDHËRINË E KOSOVËS, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, Intelektualët, me seli në Komuna Prishtinë, theksohet se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje LVV më datë 10.02.2025, ka paraqitur një ankesë, pranë Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, duke pretenduar se kandidati për deputet z. Agron Kuçi ka thyer heshtjen zgjedhore duke postuar në Facebook një fotografi ku shfaqet duke votuar dhe e ka shoqëruar me sloganin e fushatës së subjektit "Kosovë Fituese".

Fillimisht duhet theksuar se z. Kuçi në statusin e tij në rrjetin social Facebook, ka publikuar fotografinë me mbishkrinin: *"Unë dhe Leonita votuam, me besim për të ardhmen e qytetarëve tanë, në Kosovën Fituese!"* Pra, ankuesja në ankesën e saj me qëllim ka shtrembëuar tekstin që z.Kuçi, i'a ka bashkangjitur fotos me qëllim që të duket se i njëjti ka përdorur sllogenin e partisë. Megjithatë i njëjti ka përdorur termin "Kosovën Fituese", e që është fakt notor që Kosova është fituese duke mos përdorur në asnje mënyrë sloganin e partisë.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se :

-Ankesa është e bazuar.

Paneli, pas shikimit shkresave të lëndës të ofruar si provë materiale nga subjekti politik Lëvizja VETËVENDOSJE!, ka gjetur se nga kandidati për deputet, nga radhët e AAK-ALEANCA PËR ARDHËRINË E KOSOVËS, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, Intelektualët, Agron Kuqi, me qëllim të bërjes së fushatës zgjedhore gjatë ditës së votimit ka postuar fotografi në rrjetin social facebook, ku shfaqet i njëjti duke votuar me bashkëshorten e tij dhe përshkruan mbishkrinin *"Unë dhe Leonita votuam, me besim për të ardhmen e qytetarëve tanë, në Kosovën Fituese!"*. Ndërsa subjekti i tij politik gjatë fushatës ka pas sloganin *"Kosova fituese"*, çka do të thotë se në shkrimin e postuar ka përdorur sloganin subjektit të tij politik me qellim të promovimit të subjektit politik AAK dhe ndikimit tek votuesit, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 37 paragrafi 1 dhe 2 i LZP-së në të cilin nen, në mënyrë decidive thuhet se *"1. Nga hapja e Qendrave të Votimit përvotim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë: shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjëren nga Qendrat e Votimit, dhe oborri i së njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi te votuesit; bërja e fushatës në çfarëdo mënyre"*, si dhe në nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1. të Rregullores Zgjedhore NR. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve, dhe Reklamimin Financiar si dhe Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, në të cilin nen, në mënyrë decidive thuhet se: *1.Nga hapja e qendrave të votimit përvotim dhe deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike dhe përfaqësuesve të tyre u ndalohen veprimet më poshtë: 1.1. Mbajtja e takimeve për qëllime të fushatës së zgjedhjeve apo grumbullimi i zyrtarëve të subjektit politik të certifikuar në afërsi të qendrave të votimit* „, andaj Paneli gjeti se veprimet e tillë janë shkelur dispozitat e cekura.

Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e subjektit politik AAK-ALEANCA PËR ARDHËRINË E KOSOVËS, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, Intelektualët, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, ku nga kjo përgjigje ky subjekt e mohon shkeljen e bërë me pretendim se termi nuk është i njëjtë, me përdorimin e termit "Kosovën Fituese", nuk është përdorur në asnjë mënyrë sloganin e partisë. Mirëpo paneli i vlerësoi si të pabazuara, ngase me arsyet e cekura si më lartë, u vërtetua se i njëjti kishte postuar fotografinë në ditën e zgjedhjeve, ku shfaqet i njëjti duke votuar me bashkëshorten e tij, dhe kishte bërë mbishkrimin që përmban ndër të tjera edhe *sloganin e subjektit* të tij politik, slogan ky i përdorur gjatë fushatës zgjedhore. Andaj pretendimet në përgjigje në ankesë nuk janë të bazuara.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjektit në fjalë në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se subjekti politik koalicioni AAK-Nisma, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë ditës së votimit, që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, nen 118 paragrafi 1 dhe nen 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
Anr.566/2025 datë 13.02.2025

Kryesuese e Panelit,

Violeta Husaj Rugova



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi nuk tejohet ankesa konform nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së.